




SHOQËRIA KONÇESIONARE AYEN-ALB SHA



Nr. 094 Prot

Tiranë, më, 29/09 /2019

Drejtuar: MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Drejtorisë së Përgjithshme Rregulatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis

Lënda: *Informimi i publikut mbi Raportin e Studimit në kuadër të përgatitjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Projekti HPP Kalivac.*

"Kompania koncesionare Ayen - ALB" sh.a është një kompani e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L72321029P dhe me seli në Rr. Papa Gjon Pali II, Qendra e Biznesit ABA, Kati 6, Nr. 607, Tiranë, e cila është krijuar për realizimin e Hidrocentralit Kalivac, sipas Marrëveshjes së Koncesionit Nr.1268 Rep., Nr. 857 Kol., Datë 08/6/2018 "Për ndërtimin e Hidrocentralit Kalivac", nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe Ndërmarrja Koncesionare AYEN - ALB sh.a. (Koncesionari)

Aktualisht, në kuadër të Projektit është duke u zhvilluar procesi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), i cili do të duhet të përmbushë kërkesat e Korporatës Ndërkombëtare të Financës (IFC) dhe të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar Shqiptar.

Referuar Standardeve të IFC-së, procesi i VNMS-së së Projektit HPP Kalivac përbëhet nga dy faza kryesore të studimit:

- 1) Studimi Mjedisor dhe Social për Fazën e Studimit të VNMS (Scoping Phase); dhe,
- 2) Studimi për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS e Thelluar).

Studimi Mjedisor dhe Social paraqet fazën e parë të VNMS-së dhe synon t'i mundësojë Zhvilluesit që në fillim të procesit të VNMS-së, të identifikojë dhe adresojë çështjet kryesore dhe të lejojë njohjen që në fazë të hershme, të aspekteve të rëndësishme mjedisore dhe sociale të lidhen me projektin. Gjithashtu, Faza e Studimit synon të mbështesë Angazhimin me Palët e Interesuara në procesin e VNMS-së, duke i ftuar ata që të shkëmbejnë informacione dhe të komentojnë mbi qasjen e propozuar të Zhvilluesit për VNMS-në.

Mbi këtë bazë Abkons sh.p.k, dhe AYEN-ALB kanë zbatuar me përpikmëri kërkesat sipas Standardeve të IFC, duke kryer studimet përkatëse për fazën e parë (Faza e Studimit për VNMS) si të listuara si më poshtë:

- Janë zhvilluar takime me Palët e identifikuar të Interesit, ku përfshihen autoritetet në nivel kombëtar, autoritetet në nivel rajonal dhe lokal, komunitetin në zonat e ndikuara nga projekti, OJQ dhe palë të tjera të interesuara në proces; dhe,
- Është përgatitur Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNMS)

Përsa më sipër, bazuar në kërkesat e Standardeve të Performancës së IFC-së (SP1: Vlerësimi i Ndikimeve dhe Menaxhimi i Rreziqeve Mjedisore dhe Sociale) të cilat parashtrajnë informimin

e publikut mbi Raportin e Studimit në këtë fazë të hershme, ju vëmë në dispozicion dokumentet e këtij raporti me qëllim mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara. IFC parashtron rëndësinë që ka faza e informimit të publikut si dhe venia në dispozicion të dokumentave mbështetës gjatë Fazës së Studimit.

Nëpërmjet kësaj letre, **lutemi gjeni bashkëgjitur Raportin e Studimit për VNMS**

Ky raport është i publikuar elektronikisht në faqen zyrtare të kompanisë <http://kalivachpp.com/sq/esia-process/> si dhe fizikisht në secilën nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV). Komentet dhe sugjerimet do të mblidhen nëpërmjet postës elektronike dhe letrave që mund të dërgohen në adresën e kompanisë.

Çdo person, individ apo palë e interesuar mund të shfaqë komentet, sygjerimet mbi këtë raport në kontakte si më poshtë:

Email: info@kalivachpp.com

Faqe internet: <http://kalivachpp.com/sq/contact/>

Telefon: +355 44 510010/1

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II; ABA Business Center; Kati 6; Tirane

Në periudhën në vijim, Zhvilluesi do t'ju paraqesë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndryshuar dhe VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore".

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

Me respekt,

Fahrettin A. ARMAN

Administrator

